

Prishtinë, 17/11/2005  
Kodi I ZRrE-s: D\_05\_2005

## Zyra e Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Dispozitat e Ligjit nr. 2004/8 “Mbi Energjinë”;
2. Dispozitat e Ligjit nr. 2004/9 “Mbi Rregullatorin e Energjisë”;
3. Dispozitat e Udhëzimit të Përkohshëm I\_02\_2005 “Mbi Parimet e Llogaritjes së Tarifave dhe Çmimeve në Sektorin e Ngrohjes Qendrore në Kosovë për Sezonin e Ngrohjes 2005/2006”;
4. Aplikacionin për tarifën e ngrohjes në sezonin 2005/2006 dorëzuar nga ana e Ndërmarrjes së Ngrohjes Qendrore (NNQ) Termokos Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRrE) më datë 9 shtator 2005;
5. Komentet për aplikacionin për tarifën të dhëna nga ana e ZRrE-së me datë 19 shtator 2005;
6. Aplikacionin për tarifën, të rishikuar, të NNQ Termokos dorëzuar me datë 30 shtator 2005;
7. Përcaktimin e të Ardhurave të Lejuara për NNQ Termokos për sezonin e ngrohjes 2005/2006, nxjerrë nga ana e ZRrE-së me datë 20 tetor 2005, shoqëruar nga ANNEX I “RAPORTI RREGULLATIV – Metodologjia dhe Rishqyrtimi i Çmimeve për Përcaktimin e të Ardhurave të Lejuara për NNQ Termokos, për Sezonin e Ngrohjes 2005/2006”;
8. Propozimin e tarifave dorëzuar nga ana e NNQ Termokos Zyrës së Rregullatorit për Energji më 11 nëntor 2005; letra nr. 873, e datës 11 nëntor 2005;
9. Letrën nr. 878, dorëzuar nga NNQ Termokos-i me datë 14 nëntor, 2005;
10. Letrën përgjigje të ZRrE-s e datës 16 nëntor, 2005.

Ka vendosur që:

1. Të aprovojë tarifën për NNQ Termokos për tërë gjashtëmuajorin e sezonit të ngrohjes 2005/2006 siq është paraqitur në tabelën “A” dhe “B” dhe llogaritja detale e paraqitur në ANNEX II i këtij vendimi “ RAPORTI RREGULLATIV – Përcaktimi i Tarifave për NNQ Termokos për Sezonin e Ngrohjes 2005/2006”.
2. Tarifën e aprovuar do të publikohen nga ana e NNQ Termokos në njërin nga gazetën kombëtare dhe lokale që qarkullojnë në Kosovë, brenda (5) ditëve të punës, pas shpalljes dhe publikimit të vendimit nga ana e ZRrE-së në faqen e saj zyrtare në internet.
3. Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRrE) do të përdorë të drejtave sipas ligjit, për të verifikuar të dhënat e paraqitura dhe faturat në të cilat është bazuar llogaritja e tarifave gjatë periudhës së ardhshme të ngrohjes.
4. Gjatë sezonit të ngrohjes 2005/2006 NNQ Termokos mund të paraqesë para Zyrës së Rregullatorit për Energji propozimin për ndryshime të arsyeshme të tarifave të aprovuara nga ZRrE-ja në pajtim me Udhëzimet e Përkohshme të datës I\_02\_2005 “Mbi Parimet e

Llogaritjes së Tarifave dhe Çmimeve në Sektorin e Ngruhjes Qendrore në Kosovë për Sezonin e Ngruhjes 2005/2006” nxjerrë me datë 10 gusht 2005.

5. NNQ Termokos ka të drejtë ankese ndaj vendimit të ZRrE-së duke dorëzuar raportin e plotë të dëshmuar brenda dhjetë (10) ditësh kalendarik pas shpalljes dhe publikimit të këtij vendimi të ZRrE-së në faqen e saj zyrtare në internet.

**TARIFAT PËR NDËRMARRJEN E NGROHJES QENDRORE "TERMOKOS"  
PËR SEZONIN E NGROHJES 2005/2006**

**Tabela A. TARIFA PËR KONSUMATORËT E PA-NJEHSUAR**

NDËRMARRJA E NGROHJES QENDRORE "TERMOKOS"		
Komponentet e Tarifave	Amvisri	Komerical dhe Institucional
Tarifa për kapacitetin e kontraktuar të ngrohjes (komponenta fikse)	€ 0.17 / m2 per month	€ 0.20 / m2 per month
Tarifa për ngrohjen e furnizuar (komponenta variabile)	€ 0.63 / m2 per month	€ 0.76 / m2 per month

**Tabela B. TARIFA PËR KONSUMATORËT E NJEHSUAR**

NDËRMARRJA E NGROHJES QENDRORE "TERMOKOS"	
Tarifa mujore e kapacitetit të ngrohjes (komponenta fikse)	€ 1.55 / kW
Tarifa për ngrohjen e furnizuar (komponenta variabile)	€ 36.07 / MWh

Inkurajojmë Ndërmarrjet e Ngruhjes Qendrore që të matin konsumin e ngrohjes nëpër nënstacione sa më shumë që të jetë e mundur përmes njehsorëve të kalibruar të ngrohjes, posaçërisht për konsumatorët komercialë dhe institucionet.

Në emër të ZRrE-së

Dr. Nick F. Frydas  
Kryesues i Bordit